



POLICIA E KOSOVËS

AGJENDA PËR BARAZI GJINORE

NË POLICINË
E KOSOVËS
2024-2028



WWW.KOSOVOPOLICE.COM

2024-2028

192

info@kosovopolice.com
Aplikacioni:
Lajmëro Policinë

Përmbajtja:

- Mesazhi i drejtorit të
përgjithshëm të Policisë, 4
- Përmbledhje ekzekutive, 5
- Hyrje, 6
- Metodologjia, 8
- Sfondi, 10
- Objektivat, 12
- Aranzhimet e zbatimit,
monitorimit dhe
raportimit, 14
- Ndikimi buxhetor dhe
zbatimi i strategjisë, 16
- Shtojcat, 17
- Plani i veprimit, 19

www.kosovopolice.com



AGJENDA PËR
BARAZI GJINORE
NË POLICINË E
KOSOVËS DHE
PLANI I VEPRIMIT

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË



Kolonel

Gazmend HOXHA

Drejtör i Përgjithshëm i Policisë
së Republikës së Kosovës

Të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe diversiteti për organizatën të cilën unë e drejtoj janë dhe do të mbesin faktorë shtytës për ndryshime të kulturës organizative, ngritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm të Policisë. Roli i grave dhe vajzave në Policinë e Kosovës sikurse kudo tjetër në botën demokratike është i madh.

Agjenda për Barazi Gjinore e Policisë së Kosovës është në harmoni me vizionin dhe misionin tonë për një Polici demokratike, gjithëpërfshirëse dhe profesionale me qëllim që të garantojmë ambient të sigurt për jetë, zhvillim, prosperitet të përgjithshëm shoqëror, të ofrojmë shërbime efikase për qytetarin dhe komunitetin të cilit i shërbejmë.

Unë kam miratuar këtë dokument strategjik me bindjen se është në funksion të rritjes së rolit dhe pozitës së femrës në Polici dhe kjo gjithashtu do të ndikojë në rritjen e besimit të qytetarit dhe komunitetit në organizatën tonë.

Misioni jonë mbetet përmbushja e detyrave dhe përgjegjësi siç janë: ofrimi i sigurisë publike; mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut; bashkëpunimi me komunitetin dhe institucionet; kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit; parandalimi, hetimi dhe zbulimi i krimit të organizuar, korrupsioni dhe format tjera të aktiviteteve kriminale. Këto obligime dhe përgjegjësi nuk mund të realizohen pa një menaxhim efikas dhe racional të burimeve njerëzore dhe materiale, avancimit të performancës si dhe zbatimit të koncepteve bashkëkohore të policimit por edhe integritetit të perspektivës gjinore.

Të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe diversiteti për organizatën të cilën unë e drejtoj janë dhe do të mbesin faktorë shtytës për ndryshime të kulturës organizative, ngritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm të Policisë. Roli i grave dhe vajzave në Policinë e Kosovës sikurse kudo tjetër në botën demokratike është i madh. Ato janë të gatshme për të marrë përgjegjësi më të madhe brenda organizatës ku shërbejnë por edhe shoqëri përgjithësisht. Me anë të kësaj agjende ne do të përpiqemi të mbështesim dhe përkrahim ato duke qenë të vetëdijshëm se kjo do të ndikojë në zhvillimin e mëtejshëm të Policisë.

Policia e Kosovës është ndër institucionet e para në Evropën Juglindore që ka ndërmarrë masat e nevojshme për trajtim të barabartë gjinor, përmes hartimit dhe zbatimit të dokumentit paraprak për barazi gjinore. Agjenda paraprake për barazi ka avancuar qasjen dhe trajtimin, në veçanti procesin e rekrutimit, pranimit, përzgjedhjes dhe zhvillimit profesional të grave dhe burrave në Policinë e Kosovës, prandaj tani është koha për hapa të tjerë, jo vetëm të kemi vazhdimësi por edhe avancim më të madh.

Në frymën e këtij dokumenti për ne është me rëndësi që ta ndërtojmë një partneritet të shëndoshë duke rritur bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë, Agjencinë për Barazi Gjinore, OJQ-të etj., dhe të jemi model sa i përket barazisë gjinore, duke rekrutuar dhe duke avancuar kandidatë me kualitete profesionale dhe vlera të larta.

Përmes kësaj agjende jam i bindur se do të ketë avancim të integritit të perspektivës gjinore në PK, do të ketë ngritje profesionale, integritet të lartë, arritje akoma më të mëdha të grave dhe vajzave në punën policore duke shërbyer si model edhe për të tjerët.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjenda për Barazi Gjinore në Policinë e Kosovës dhe Plan i Veprimit 2024–2028 është dokument strategjik që shërben si udhëzues për Policinë në raport me diversitetin, të drejtat e njeriut, ngritjen dhe zhvillimin profesional. Ky dokument siguron një qasje të përgjegjshme të perspektivës gjinore në të gjitha proceset dhe praktikatat tona, me qëllim të rritjes së besimit në Polici.

Dokumenti siguron mundësi shtesë për ndryshime kulturore përbrenda organizatës dhe respektim të të drejtave të njeriut si element thelbësor për ofrimin e një policimi efektiv dhe efikas drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara. Për më tepër, agjenda ofron mbështetje në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi nga instrumentet vendore dhe ndërkombëtare si dhe politikat shtetërore.

Agjenda për Barazi Gjinore në Policinë e Kosovës dhe Plan i Veprimit 2021–2023 ka avancuar qasjen dhe trajtimin, në veçanti procesin e rekrutimit, pranimit, përzgjedhjes dhe zhvillimit profesional të grave dhe burrave në Policinë e Kosovës, prandaj kjo agjendë është vazhdimësi e zbatimit të agjendës paraprake.

Referuar raporteve dhe sukseseve ekzistuese, me këtë dokument është siguruar një qasje shumë më e përgjegjshme e perspektivës gjinore.

Krijimi i dokumentit të Agjendës për Barazi Gjinore është në përputhje dhe harmoni të plotë me ligjet dhe normat e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe ato ndërkombëtare të trajtimit të barabartë gjinor i cili shërben si instrument/mekanizëm i qëndrueshëm në garantimin e barabartë të qasjes për të gjithë të punësuarit në Policinë e Kosovës duke aplikuar standardet më të larta dhe praktikatat më bashkëkohore në rajon dhe më gjerë.



I. HYRJE

Policia e Kosovës bazuar në vizionin dhe misionin e saj është ndër institucionet e para në Evropën Juglindore që ka ndërmarrë masat e nevojshme për trajtim të barabartë gjinor, përmes hartimit dhe zbatimit të dokumentit paraprak për barazi gjinore. Kjo agjendë është hartuar për të avancuar tutje objektivat kyçe të perspektivës gjinore me theks të veçantë: rritjes së pjesëmarrjes aktive të grave në të gjitha nivelet brenda organizatës; rritjes dhe mbështetjes së zhvillimit të karrierës. Përmes kësaj synohet avancimi i grave në rolet vendimmarrëse, udhëheqëse, përfshirë integrimin gjinor të tyre në të gjithë strukturën organizative të Policisë së Kosovës si dhe angazhimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të specializuara policore që ndërlidhen me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Ky dokument mundëson integrimin efektiv dhe të qëndrueshëm të grave dhe burrave brenda organizatës, duke i respektuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Vlerat e Agjendës Gjinore për PK-në kanë për qëllim drejtimin, orientimin dhe zhvillimin e një policie gjithëpërfshirëse në aspektin gjinor, si:

- Promovimi i mundësive të barabarta për gratë, në të gjitha nivelet dhe pozitat në Policinë Kosovës;
- Partneritetet me komunitetin, për të ofruar shërbim profesional dhe gjithëpërfshirës.
- Ndërtimi i besimit të ndërsjellë me komunitetin;
- Krijimi i një mjedisi dhe klime pozitive brenda organizatës, me qëllim të promovimit të sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së grave dhe burrave në punë;
- Vendimmarrje të përgjegjshme dhe transparente;
- Inkurajimi i kreativitetit dhe llojllojshmërisë së ideve.




Policia e Kosovës ka të punësuar punonjës që reflektojnë diversitetet dhe shumëllojshmëri të të gjitha komunitetave që jetojnë në Kosovë, kjo ndikon në nivelin e profesionalizmit dhe përkrahjen nga komuniteti.

Policia e Kosovës angazhohet për të ndihmuar avancimin e grave, rritjen e rolit të grave në proceset e sigurisë dhe paqes, në qëndrimin e grave në shërbim-polici si dhe fuqizimin e tyre. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit në karrierë të grave në kuadër të Policisë, përmes respektimit të konkurrencës dhe mundësive të barabarta. Ngritja e rolit të grave në procese brendshme të Policisë, si dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në mbledhjen e informatave të cilat ndikojnë në parandalimin e kryerjes së veprave penale, hetimin e veprave penale, në veçanti rastet të cilat kanë të bëjnë me dhunën në baza gjinore.

Policia e Kosovës në filllet e saj është përballur me stereotipet se puna policore është kryesisht fushë e burrave. Me punën dhe angazhimin e grave këto stereotipe pothuajse janë zhdukur. Fal legjislacionit në fuqi dhe politikave në nivel nacional është mundësuar integrimi i perspektivës gjinore dhe pjesëmarrja e plotë dhe e barabartë e përfaqësimit gjinor në Polici. Për shkak të interesimit të ulët të grave për të aplikuar në Polici, me qëllim të arritjes së barazisë gjinore dhe etnike Policia e Kosovës ka aplikuar masa afirmative duke organizuar konkurse të veçanta vetëm për gra dhe pjesëtarë të komuniteteve, të cilat kanë qenë të përfaqësuara në numër më të vogël. Përmes këtij dokumenti strategjik ne zotohemi të vazhdojmë ta ngrisim vetëdijesimin dhe angazhimin e stafit, në mënyrë që të kuptohet rëndësia që ka diversiteti, barazia gjinore dhe gjithëpërfshirja.

Qëllimi i këtij dokumenti është të zhvillojë një kulturë institucionale dhe gjithëpërfshirëse, ku pavarësisht prejardhjes secili ndjehet i sigurt t'i shpalos karakteristikat dhe vlerat e tij/saj personale si dhe të zhvillojë një fuqi punëtore të talentuar që i respekton të gjitha kulturat dhe diferencat e të tjerëve.

Qëllim final i kësaj strategjie është krijimi i një mjedisi që i mundëson tërë stafit pa përjashtim zhvillimin dhe përparimin e vazhdueshëm në karrierë profesionale.



Përmes këtij dokumenti strategjik ne zotohemi të vazhdojmë ta ngrisim vetëdijesimin dhe angazhimin e stafit tonë, në mënyrë që të kuptohet rëndësia që ka diversiteti, barazia gjinore dhe gjithëpërfshirja.

III. METODOLOGJIA

Agjenda për Barazi Gjinore në Policinë e Kosovës dhe Plan i Veprimit 2024–2028 është hartuar si vazhdimësi e Agjendës për Barazi Gjinore në Policinë e Kosovës dhe Planit të Veprimit 2021–2023 dhe bazuar në Programin për Barazi Gjinore të Qeverisë së Kosovës 2020–2024; Ligji për Barazi Gjinore; Planin Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës 2021–2025; Strategjinë e Burimeve Njerëzore dhe Planin e Veprimit 2021–2025 si dhe Planit Vjetor të Punës së Policisë së Kosovës për vitin 2023. Hartimi i Agjendës Gjinore është bërë në harmoni të plotë me Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.



Për qëllime të hartimit të këtij dokumenti me vendimin nr. 01/0566 të datës 03.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm është themeluar grupi i punës ku janë të përfshira të gjitha strukturat përgjegjëse në kuadër të Policisë së Kosovës. Në kuadër të këtij procesi janë angazhuar zyrtarë nga: Departamenti i Burimeve Njerëzore; Departamenti për Mbështetje; Departamenti i Hetimeve; Departamenti i Kufirit; Shoqata e Grave në Polici Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore; Këshilltari për Projekte në Policinë e Kosovës, Drejtoria për Komunikim me Publikun dhe Përfaqësues nga Drejtoritë Rajonale.

Ky dokument është hartuar me përfshirjen e të gjithë akterëve të grupit punues ndërsa më qëllim të finalizimit të draftit është mbajtur punëtorja në Prevallë prej datës 29.11.2023 deri më 01.12.2023 e mbështetur nga Misioni OSBE-së në Kosovë.

Në kuadër të procesit të hartimit të këtij dokumenti janë konsultuar dhe e kanë përkrahur Policinë e Kosovës edhe institucionet ndërkombëtare si: Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, ICITAP-i, INL-ja, UN WOMEN, OSBE-ja, Zyra e BE-së në Kosovës dhe EULEX.

Agjenda është hartuar duke u bazuar në vlerësimet paraprake të bëra sa i përket zbatimit të dokumentit paraprak.

Si pjesë e metodologjisë së punës është themeluar dhe një nëngrup i ngushtë me detyrën për të hartuar një dokument fillestar për diskutim në grupin e gjerë. Grupi i ngushtë punues ka qenë i përkrahur me komentet dhe propozime nga anëtarët e tjerë të grupit të gjerë punues por edhe kontributin e institucioneve mbështetëse ndërkombëtare.

Përpos instrumenteve ndërkombëtare janë marrë për bazë edhe korniza ligjore në fuqi sa i përket barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave si dhe korniza e politikave vendore sa i përket veprimeve për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

HARTIMI I AGJENDËS PËR BARAZI GJINORE KA PËRFSHIRË KATËR FAZA KRYESORE :

- Mbledhjen e të dhënave, shqyrtimin dhe analizën e problemeve;
- Hartimin e Agjendës dhe planit të saj të veprimit;
- Konsultimet e brendshme dhe të jashtme;
- Miratimin e Agjendës Gjinore.

IV. SFONDI

Bazuar në analizën e statusit të femrave të punësuar në Policinë e Kosovës dhe hulumtimin për barazi gjinore dhe diversitet, numri i femrave të punësuar në Policinë e Kosovës ka tendencë të ngritjes së lehtë. Referuar statistikave të personelit, Policia e Kosovës aktualisht numëron 8865 punonjës, prej të cilëve 7992 janë zyrtarë policorë, ndërsa 873 staf civilë, ose shprehur në përqindje rreth 85.20% e personelit të PK-së i takojnë gjinisë mashkullore ndërsa rreth 14.80% gjinisë femërore, 90.66% i takojnë përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa 9.34% i takojnë grupeve të tjera etnike. Në aspektin krahasimor me popullatën që jeton në Kosovës, duke ju referuar raportit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për regjistrimin e popullsisë, kemi 875,900 meshkuj dhe 863,925 femra. Kjo tregon numrin e përafërt të përfaqësimit në popullatë, ndërsa kjo nuk reflekton në numrin e përfaqësimit të femrës në Policinë e Kosovës e cila është 14.80%. Në kuadër të stafit të uniformuar përqindja e femrave është 12.89%, ndërsa në kuadër të të punësuarve staf civil përqindja e numrit të femrave është 32.30%.

Referuar në atë që u tha më lartë dhe duke u mbështetur në të dhënat e numrit të popullsisë si dhe numrit të personelit policorë, konkretisht përfaqësimit të tyre në Policinë e Kosovës, përfshirja gjinore aktualisht nuk është në nivelin e dëshirueshëm. Bazuar në legjislacionin në fuqi, nevojën e rritjes së përfaqësimit të femrave baraspeshës gjinore, Policia e Kosovës ka aplikuar masat e përkohshme afirmative në vitet 2018, 2021 dhe 2023.



Policia e Kosovës në konkursin publik për punësim të zyrtarëve policorë, të organizuar në vitin 2018, me qëllim të rritjes së përfaqësimit të zyrtareve policore gra, ka ndërmarrë masat e përkohshme afirmative, përmes të cilave nga të gjithë kandidatët që kanë plotësuar kushtet dhe kanë kaluar pragun e kalueshmërisë 70%, përparësi u është dhënë gjinisë femërorë. Përmes zbatimit të masave të veçanta të përkohshme, PK-ja arriti të punësojë 205 zyrtare policore apo shprehur në përqindje 24%. Aplikimi i masave të veçanta të përkohshme (afatizuar), me qëllim të përsheptimit të realizmit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve, ishte i bazuar në vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm me Nr.01/0188, datë 26.03.2018.



Bazuar në legjislacionin në fuqi, nevojën e rritjes së përfaqësimit të femrave baraspeshës gjinore, Policia e Kosovës ka aplikuar masat e përkohshme afirmative në vitet 2018, 2021 dhe 2023.

Këtij procesi i kanë paraprirë takime dhe këshillime me autoritetet kompetente siç janë Agjencinë për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit, Avokati i Popullit etj.

Për vitin 2021, aplikimi i masave të veçanta të përkohshme (afatizuar), me qëllim të përsheptimit të realizmit të barazisë faktike midis grave dhe burrave, ishte i bazuar në Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm me Nr.ref. 01/0847 i datës 27/10/2021, ku në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej 11841, prej tyre femra 2140 apo 18.07% dhe 9701 meshkuj apo 81.93%. Nga ky konkurs kanë vijuar trajnimin bazik me gjithsejtë 441 kadetë, prej tyre 388 meshkuj dhe 53 femra. Kurse në gjeneratën e fundit me gjithsej 427 kadetë, prej tyre 380 meshkuj kurse 47 femra.


Gjithashtu në vitin 2023, me Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm me Nr. ref:01/0344 të datës 20.06.2023, në konkursin e shpallur për plotësim të pozitave të lira për zyrtar policor janë zbatuar masat e veçanta të përkohshme afirmative. Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 4389 kandidatë, prej tyre femra 687 apo 15.65% dhe 3702 meshkuj apo 84.35%, ku nga lista meritore në gjeneratën e 59 janë përzgjedhur 449 kadetë nga i cili numër 101 janë femra apo rreth 22.5%.

V. OBJEKTIVAT

Në kuadër të këtij dokumenti strategjik janë paparaparë gjithsej 5 objektiva strategjike, 13 objektiva specifike si dhe gjithsej 46 aktivitete. Dokumenti pasqyron në mënyrë të detajuar në kuadër të planit të veprimit indikatorët matës për matjen e arritjes së secilit objektiv specifik përfshirë edhe progresin për tri vitet e ardhshme. Të gjitha aktivitetet janë formuluar në mënyrë konkrete duke paparaparë për secilin aktivitet afatet e zbatimit, kostoja e aktivitetit, burimet e financimit, organin përgjegjës dhe organet mbështetëse dhe produktet për secilin aktivitet.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË PËRCAKTUAR E AGJENDËN GJINORE JANË:

- Objektivi strategjik 1: Avancimi i pjesëmarrjes, përfaqësimit të barabartë dhe kontributit të grave në të gjitha pozitat, gradat dhe nivelet vendimmarrëse;
- Objektivi strategjik 2: Integrimi i perspektivës gjinore përmes zhvillimit profesional dhe gjithëpërfshirëse në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Objektivi strategjik 3: Fuqizimi i rolit të grave police në parandalimin dhe hetimin e dhunës në baza gjinore;
- Objektivi strategjik 4: Ofrimi i një mjedisi të favorshëm dhe jo diskriminues për gratë dhe burrat në Policinë e Kosovës dhe
- Objektivi strategjik 5: Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies së personelit policorë me theks të veçantë për gratë në kuadër të Policisë.




Objektivat dhe aktivitetet janë përcaktuar mbështetur në nevojën që ka Policia e Kosovës për avancimin dhe përfaqësimin e grave në kuadër të të gjitha strukturave të Policisë. Gjithashtu me këto tentohet të arrihet integrimi i perspektivës gjinore në zhvillimin profesional dhe zbatimin e dispozitave ligjore sa i përket perspektivës gjinore në përgjithësi por në veçanti në Polici.

Me anë të këtyre objektivave dhe aktiviteteve synohet të fuqizohet roli i grave në përfshirjen më të madhe të tyre në parandalimin dhe hetimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Me qëllim të përmirësimit mjedisit, eliminimin e çfarëdo forme të diskriminimit si dhe promovimin e shëndetit dhe ngritjen e mirëqenies së grave në Polici janë paraparë disa objektiva dhe aktivitete konkrete.

Zbatimi praktik i objektivave dhe aktiviteteve do të avancojë më shumë barazinë gjinore dhe do të forcojë më shumë pozitën e grave dhe vajzave në Policinë e Kosovës.



VI. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

ZBATIMI

Procesi i zbatimit të strategjisë do të jetë një proces i realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike si dhe aktiviteteve. Plani i veprimit ka paraparë aktivitete konkrete dhe të matshme që do të zbatohen për periudhën e strategjisë pesë (5) vjeçare, nga viti 2024–2028. Gjithashtu, Plani i veprimit përcakton njësitë përgjegjëse për zbatimin e këtyre aktiviteteve.

MONITORIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve do të jetë pjesë përbërëse e procesit së Agjendës për Barazi Gjinore, si dhe element kyç në përmbushjen e saj.



Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Diversitetet është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të strategjisë. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve i raportojnë në mënyrë periodike zyrës për të drejtat e njeriut dhe diversitetet rreth zbatimit të planit të veprimit.

ORGANIZATAT VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE:

Roli i përfaqësuesëve të Organizatave Vendore dhe Ndërkombëtare është vullnetar dhe mbështetet në dëshirën e tyre për të përkrahë Policinë e Kosovës në zbatimin e këtij dokumenti. Në veçanti mbështetja pritët të jetënë shkëmbim të përvojave, realizim të projekteve të përbashkëta si dhe realizimin e vizitave studimore në shtetet ku ekzistojnë standarde të larta të barazisë gjinore, si dhe janë model i mirë i fuqizimit dhe avancimit të gruas.

RISHIKIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË VEPRIMIT:

Me propozim të Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Diverzitet, Drejtori i Përgjithshëm themelon një grup punues të përkohshëm për të bërë rishikimin vjetor të planit të veprimit, përmes së cilit vlerësohet zbatueshmëria e planit të veprimit, ndikimit në praktikë, rishikimi i aktiviteteve duke siguruar planifikimin e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin efektiv të objektivave strategjike dhe harmonizimin me trendët e identifikuara.


Vlerësimi përfundimtar i zbatimit të agjendës bëhet në fund të afatit të mbarimit të këtij dokumenti strategjik.

MËSIMET E MËSUARA:

Do të sigurohet mësim i vazhdueshëm gjatë zbatimit të Agjendës për Barazi Gjinore të Policisë së Kosovës përmes një raporti vjetor i cili:

- Do të realizojë regjistrimin e arritjeve dhe sfidave në zbatimin e planit të veprimit;
- Të përdorë mësimet e nxjerra si dëshmi për zhvillimin e veprimeve në planin e ardhshëm të veprimit.

Pjesë e obligimeve sipas kësaj strategjie, në dhjetor të secilit viti do të dorëzohet raport vjetor i progresit Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Agjencisë për Barazi Gjinore të Qeverisë.



VII. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i strategjisë

Agjenda Gjimore në aspektin financiar mbështetet nga Policia e Kosovës si dhe përkrahet nga partnerët donator.

Kosto financiare për planin e veprimit të Agjendës Gjimore në Policinë e Kosovës për vitin 2024 është 113,000 euro, për vitin 2025 është 179,200 euro ndërsa për vitin 2026 është 167,550 euro.



VIII. Shtojcat

Shtojca 1 Pjesëmarrja e femrave në PK ndër vite e shprehur edhe në përqindje (1999-2023)

GJINIA / VITI	FEMRA	MESHKUJ	TOTALI	FEMRA %
1999	72	278	350	20.57%
2000	642	2728	3370	19.05%
2001	758	3482	4240	17.88%
2002	800	4367	5167	15.48%
2003	841	4860	5701	14.75%
2004	888	5373	6261	14.18%
2005	949	5906	6855	13.84%
2006	978	6264	7242	13.50%
2007	1349	7681	9030	14.94%
2008	1322	7554	8876	14.89%
2009	1296	7406	8702	14.89%
2010	1267	7318	8585	14.76%
2011	1213	7119	8332	14.56%
2012	1256	7189	8445	14.87%
2013	1242	7228	8470	14.66%
2014	1249	7568	8817	14.17%
2015	1252	7724	8976	13.95%
2016	1236	7678	8914	13.87%
2017	1232	7520	8752	14.08%
2018	1222	7411	8633	14.15%
2019	1403	7916	9319	15.06%
2020	1383	7765	9148	15.12%
2021	1367	7786	9153	14.93%
2022	1284	7410	8694	14.77%
2023	1312	7553	8865	14.80%

Shtojca 2 - Gjendja aktuale sipas gradës dhe gjinisë

GRADA	M	F	TOTALI
Kolonel	24	4	28
Nënkolonel	41	3	44
Major	78	8	86
Kapiten	134	15	149
Toger	288	27	315
Rreshter	779	95	874
Polic	298	55	353
Polic i lartë	4501	716	5217
Polic i ri	798	103	901
Total	6941	1026	7967

PLANI I VEPRIMIT 2024 -2026 I AGJENDES PËR BARAZI GJINORE NË POLICINË E KOSOVËS



PLANI I VEPRIMIT 2024-2026								
Objekтиви Strategjik 1: PJESËMARRJA, PËRFAQËSIMI I BARABARTË DHE KONTRIBUTI NË TË GJITHA POZITAT, GRADAT DHE NIVELET VENDIMARRËSE								
Objekтиви Specifik 1.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Rritja e numrit të të punësuarave dhe të graduarave gra dhe vajza në Policinë e Kosovës në të gjitha nivelet përmes zbatimit të masave afirmative.	Përqindja e rritur e grave dhe vajzave në Polici krahasuar me vitet paraprake				70%	75%	80%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Organizimi i aktiviteteve/fushatave inkurajuese për aplikimin e grave në konkurset e hapura për punonjësit e Policisë	TM 4 2024 TM4 2026	1,000 €	5,000 €	1,000 €	BPK dhe partnererët	Divizioni për Personel dhe Administratë	Drejtoria për Komunikim me Publikun; Drejtoritë Rajonale; Departamenti për Shërbime Mbështetëse	Punëtori; Pjesëmarrje në media; Fushatë promovuese; Spote promovuese në rrjetet sociale. Aktivitete që e forcojnë fushatën për inkurajim
2. Rekrutimi i orientuar në gra dhe vajza	TM2 2025		3,000 €		BPK dhe partnererët	Divizioni për Personel dhe Administratë	Departamentet Policore dhe partnererët	Numri i grave të punësuar në Polici. Organizimi i një procesi të rekrutimit të veçantë për gra
3.Organizimi i trajnimeve përgaditore për zhvillim në karrierë	TM1 2024 TM4 2026	100 €	100 €	100 €	BPK	Divizioni i Trajnimeve, Drejtoria për Zhvillim të performancës dhe Karrierës	Departamentet Policore	Organizimi i trajnimeve përgaditore për gradën e rreshterit për 716 zyrtare. Organizimi i trajnimeve përgaditore për vijën e parë dhe të mesme të menaxhimit
Objekтиви specifik 1.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Të rishikohen politikat e përfshirjes së grave në të gjitha nivelet e organizimit të Policisë së Kosovës	Politikat e rishikuara, miratimi dhe zbatimi i kriterëve për përfshirjen e grave në njësitë e caktuara				40%	50%	60%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Të bëhet një studim i hollësishëm për përfaqësimin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet dhe të hartohet raporti me të gjeturat	TM3 2024	500 €			BPK	Divizioni për Personel dhe Administratë	Departamentet Policore	Raporti i hulumtimit i përpiluar me rekomandime konkrete
2. Propozimi për plotësim të pozitave të lira në pozitat dhe gradat përkatëse	TM1 2024 TM4 2026	100 €	100 €	100 €	BPK	Të gjitha Departamentet	Divizioni për Personel dhe Administratë	Përzgjedhja dhe caktimi i zyrtarëve në pozita të caktuara
3. Zbatimi i kriterëve të përcaktuara për përfshirjen e grave në njësi speciale	TM1 2024 TM4 2024	100 €			BPK	Departamenti i Njësive Speciale	Divizioni për Personel dhe Administratë	Miratimi i raportit. Ndryshim plotësimi i PSO-së sipas kriterëve të ndryshuara bazuar në raport
Objekтиви specifik 1.3	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Përfshirja gjinore në grupet punuese në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave në kuadër të PK-së	Niveli i përfshirjes së grave në grupet punuese në hartimin dhe zbatimin e politikave				80%	90%	100%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Respektimi i barazisë gjinore në kuadër të komisioneve të përhershme dhe të përkohshme	TM1 2024 TM4 2026				BPK	Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm	Departamenti për Burime Njerëzore dhe Departamentet tjera	Numri i grave të përfshira në komisione të përkohshme dhe të përhershme
2. Respektimi i barazisë gjinore në kuadër të paneleve	TM1 2024 TM4 2026				BPK	Departamenti për Burime Njerëzore	Departamentet Policore	Numri i grave të përfshira në panele
3. Respektimi i barazisë gjinore në kuadër të grupeve punuese për hartim të strategjive, planeve të punës, akteve nënligjore, etj.	TM1 2024 TM4 2026				BPK	Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm	Departamenti për Burime Njerëzore dhe Departamentet tjera	Numri i grave të përfshira në grupe punuese për hartimin e strategjive, paneleve të punës, akteve nënligjore, etj.

PLANI I VEPRIMIT 2024-2026								
Objektivi Strategjik 2: INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE PËRMES ZHVILLIMIT PROFESIONAL DHE GJITHËPËRFSHIRJES NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN NË FUQI								
Objektivi Specifik 2.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Integrimi i komponentës gjinore në trajnimet bazë dhe të specializuara	Rritja e pjesëmarrjes në trajnime të specializuara, avancuara dhe ato menaxhuese				70%	80%	90%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Realizimi i programit të intershipit në fushat e specializuara, të udhëheqjes së operacioneve dhe të komandimit	TM1 2024 TM4 2026				PK dhe partnererët	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore	Realizimi i tri vizitave në kuadër të programit të intershipit. Dhënia e mundësisë 60 grave për realizimin e programit të intershipit të pozitave të nivelit të vijës së parë dhe vijës së mesme të menaxhimit të Policisë
2. Përfshirja e grave në trajnimin për Programin e aftësimit të Instruktorëve (PAI)	TM1 2024 TM4 2026				PK dhe partnererët	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore	Organizimi i dy trajnimeve për PAI me pjesëmarrje të 20 grave
3. Përfshirja e grave në programet e trajnimeve për Trajnimin për Trajner (TT).	TM1 2024 TM4 2026				PK dhe partnererët	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore	Organizimi i trajnimit për trajner me pjesëmarrje të 5 grave.
Objektivi Specifik 2.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Krijimi dhe zhvillimi i programit të mentorimit brenda PK-së	Programi i mentorimit i hartuar, miratuar dhe zbatuar				0%	50%	100%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Nënshkrimi i protokollit të bashkëpunimit me Kolegjin Policor në fushën e ndërtimit të kapaciteteve të grave dhe burrave për të promovuar diversitetin, përfshirjen dhe barazinë brenda organizatave	TM1 2024				PK dhe partnererët	Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm	Departamentet Policore	Protokolli i miratuar
2. Vizita studimore në vendet me standarde të larta në këtë fushë	TM1 2024 TM4 2026	20,000 €	20,000 €	20,000 €	PK dhe partnererët	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore dhe partnerët	3 vizita të realizuara
3. Hartimi i programit	TM4 2024	5,000 €			PK dhe partnererët	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore	Programi i hartuar
4. Trajnimi&Certifikimi	TM2 2025		30,000 €		PK dhe partnererët	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore dhe partnerët	40 mentor të trajnuar dhe certifikuar
5. Zbatimi i mentorimit në praktikë	TM3 2025 TM4 2026		5,000 €	5,000 €	PK dhe partnererët	Drejtoria për Zhvillim të Performancës dhe Karrierës	Departamentet Policore	80 zyrtarë të mentoruar
Objektivi Specifik 2.3	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Pasqyrimi i sukseseve dhe kontributit të grave në PK	Aktivitetet e realizuara me pjesëmarrjen e grave në prezantimin e punës së Policisë				60%	70%	80%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Dokumentar me përmbajtje të aktiviteteve të suksesshme në Policinë e Kosovës	TM1 2024 TM4 2026	3,000 €	4,000 €	5,000 €	PK dhe partnererët	DIMP	Departamentet Policore dhe partnerët (p.sh shkollat e gazetarisë)	Themelimi i grupit punues për realizimin e dokumentarit. Tre dokumentarë të zhvilluar në fushat: Zhvillimi dhe avancimi i grave në PK përgjatë viteve. Prezantimi i të arrituarve në fusha/profile të ndryshme. Storie/trëfim suksesi
2.Promovimi i grave përmes rrjeteve sociale	TM1 2024 TM4 2026	3,000 €	4,000 €	5,000 €	PK dhe partnererët	DIMP	Departamentet Policore dhe partnerët	Tre video spote të realizuara brenda vitit
3. Përgatitja për paraqitje të grave dhe burrave në programe të mediave elektronike	TM1 2024 TM4 2026				PK dhe partnererët	DIMP	Departamentet Policore dhe partnerët	Trajnim për paraqitje mediale dhe audiencë. Pjesëmarrja e grave në emisione mediale

PLANI I VEPRIMIT 2024-2026								
Objektivi Strategjik 3: FUQIZIMI I ROLIT TË GRAVE NË PARANDALIMIN DHE HETIMIN E DHUNËS NË BAZA GJINORE								
Objektivi Specifik 3.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Ngritja e kapaciteteve të grave brenda PK-së në parandalim dhe hetim të dhunës në bazë gjinore	Angazhimi i grave në parandalimin dhe hetimin e dhunës me bazë gjinore				60%	80%	100%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Rishikimi dhe plotësimi i kurrikulave trajnuese për policinë në trajnimin themelor dhe të avancuar për DHF dhe DHBGJ	TM2 2024				PK	Divizioni i Trajnimeve dhe Divizioni i Policimit në Bashkësi	Departamentet Policore dhe partnerët	Themelimi i grupit punues për rishikim të kurrikulave Kurrikulat e trajnimit të rishikuara dhe të aprovuara
2. Trajnimi i grave police në trajtimin e DHF dhe DHBGJ	TM4 2024 TM4 2026				PK dhe partnerët	Divizioni i Policimit në Bashkësi	Divizioni i Trajnimeve	60 zyrtarë reagues dhe dispeçerë të trajnuar për vit kalendarik
3. Pjesëmarrja aktive e grave police në fushatat e vetëdijësimit për parandalimin e DHF dhe DHBGJ	TM1 2024 TM4 2026				PK dhe partnerët	Divizioni i Policimit në Bashkësi	DIMP	30 gra zyrtare policore të angazhuara në fushatat vetëdijësuese për vit kalendarik
4. Organizimi i trajnimeve për të gjithë personelin e angazhuar për hetimin e DHF dhe krimeve të tjera DHBGJ vijnë trajnime të specializuara dhe avancuara	TM1 2024 TM4 2026				PK dhe partnerët	Divizioni i Trajnimeve	Divizioni i Policimit në Bashkësi	Dy trajnime në vit me pjesëmarrjen e 50 zyrtarëve policor
Objektivi Specifik 3.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Rritja e bashkëpunimit të PK-së me organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare kompetente për parandalimin dhe luftimin e DHF dhe DHBGJ	Bashkëpunimi i ngritur i PK-së me organizatat tjera për parandalimin dhe luftimin e DHF dhe DHBGJ				60%	70%	80%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Promovimi i kontributit të grave në trajtimin e DHF dhe DHBGJ	TM1 2024 TM4 2026				PK dhe partnerët	DIMP	Drejtoria e dhunës në familje, Departamentet policore	Një emision i realizuar për çdo vit
2. Shkëmbimi i përvojave policore në trajtimin e rasteve të DHF dhe DHBGJ me vendet e BE-së	TM1 2024 TM4 2026	20,000 €	20,000 €	20,000 €	PK dhe partnerët	Divizioni i Policimit në Bashkësi	Departamentet Policore	Shkëmbim të përvojave, synohet 40 zyrtar policor (njësitë reaguese dhe hetuesit e DHF dhe DHBGJ)
PLANI I VEPRIMIT 2024-2026								
Objektivi Strategjik 4: OFRIMI I NJË MJEDISI TË FAVORSHËM DHE JO DISKRIMINUES PËR GRATË DHE BURRAT NË POLICINË E KOSOVËS								
Objektivi Specifik 4.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza	Caku 2025	Caku 2026	
Krijimi i një mjedisi të përgjeshëm ndaj gjinisë	Mjedisi i favorshëm dhe jo diskriminues në PK				40%	60%	80%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Huluntim për sigurinë në vendin e punës në lidhje me diskriminimin dhe ngacmimet seksuale	TM4 2024	10,000 €			PK dhe partnerët	Departamenti për Burime Njerëzore	Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, Departamentet Policore	Themelimi i grupit punues për realizim të huluntimit. Pyetësi i hartuar. Hartimi i raportit me të gjetura dhe rekomandime
2. Hartimi i udhëzuesit për adresimin e shqetësimeve seksuale në PK	TM2 2024	1,000 €			PK dhe partnerët	DPSÇL	Departamentet Policore	Themelimi i grupit punues; Punëtori; Udhëzuesi i hartuar
3. Hartimi dhe miratimi i programit të trajnimit për parandalim dhe mbrojtje nga ngacmimet seksuale në vendin e punës	TM1 2024				PK	Divizioni i Trajnimeve		Programi i hartuar dhe aprovuar
4. Trajnimi i trajnerëve për programin e parandalimit dhe mbrojtjes nga ngacmimet seksuale në vendin e punës	TM4 2024 TM4 2026	1,000 €	1,000 €	1,000 €	PK dhe partnerët	Divizioni i Trajnimeve	PK dhe partnerët	20 trajnerë të certifikuar

5. Shkëmbimi i përvojave për trajnimin për trajner	TM1 2025 TM4 2026		10,000 €	5,000 €	PK dhe partnerët	Divizioni i Trajnimeve	PK dhe partnerët	Organizimi i një punëtorie; Tri vizita studimore nga 5 trajner për vit
6. Trajnimi për menaxhment mbi ndërgjegjësimin gjinor në kuadër të trajnimit të ricertifikimit	TM1 2024 TM4 2026				PK	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore	Për vitin 2024 dhe 2025 janë planifikuar të mbahen 29 trajnime me 441 pjesëmarrës për këto grada "Ricertifikim për nivelin e lartë të menaxhimit" PK_DT-10-004 "Ricertifikim vija e mesme Toger, Kapiten" PK-DT-10-003 "Ricertifikim vija e parë e menaxhimit Rreshter "PK-DT-10-002
Objektivi Specifik 4.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit					Baza	Caku 2025	Caku 2026
Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës fizike dhe përshtatja e tyre në raport me specifikat gjinore	Infrastruktura fizike e identifikuar dhe përmirësimi i saj në raport me specifikat gjinore					40%	50%	55%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Studim fizibiliteti për përmirësimin e infrastrukturës aktuale në bazë të ndjeshmërisë gjinore	TM1 2024 TM4 2024				PK	DSHM	Departamentet Policore	Themelimi i grupit punues Raporti i studimit si aktivitet me rekomandime
2. Përfshirja e ndjeshmërisë gjinore në projektet e ardhshme të infrastrukturës	TM1 2024 TM4 2026	36,000 €	48,500 €	92,750 €	PK	DSHM	Departamentet Policore	Pesë objekte policore
3. Nyje sanitare në të gjitha poligonet e gjuajtjes konform ndjeshmërisë gjinore	TM1 2024 TM4 2026	6,800 €	13,600 €	7,200 €	PK	DSHM	Departamentet Policore	Katër poligone
Objektivi Specifik 4.3	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit					Baza	Caku 2025	Caku 2026
Standardizimi i uniformës, veshjeve civile dhe pajisjeve policore në raport me perspektivën gjinore	Uniforma e standardizuar, veshja civile dhe pajisjet e përshtatshme në raport me gjininë					40%	45%	50%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Huluntim në lidhje me përshtatshmërinë e uniformës sipas specifikave gjinore	TM1 2024				PK dhe partnerët	DSHM	Departamentet Policore	Themelimi i grupit punues Raporti i huluntimit
2. Dizajnimi i uniformës policore konform specifikave gjinore	TM1 2025 TM2 2025		9,500 €		PK	DSHM	Departamentet Policore	Themelimi i grupit punues Draft propozimi i hartuar
3. Hartimi i specifikave të pajisjeve policore sipas specifikave gjinore	TM1 2025 TM2 2025				PK	DSHM	Departamentet Policore	Themelimi i grupit punues Draft propozimi i hartuar
4. Hartimi i specifikave të veshjeve për punonjësit e stafit civil konform vendit të punës dhe sipas gjinisë	TM2 2025				PK	DSHM	Departamentet Policore	Themelimi i grupit punues Hartimi dhe miratimi i katalogut të veshjeve për punonjësit civil të PK-së
PLANI I VEPRIMIT 2024-2026								
Objektivi Strategjik 5: PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE MIRËQENIES SË PERSONELIT POLICOR ME THEKS TË VEÇANTË PË GRATË NË KUADËR TË POLICISË								
Objektivi Specifik 5.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit					Baza	Caku 2025	Caku 2026
Promovimi dhe kujdesi për shëndetin për gratë në PK	Ngritja e vetëdijësimit dhe përkrahjes për shëndetin e grave në PK					40%	50%	60%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Sensibilizimi rreth ndryshimeve në sferën emocionale tek gratë me PMS dhe menopauzë	TM1 2024 TM4 2026	400 €	400 €	400 €	PK	DSHS	DIMP, DSHM Divizioni i Trajnimeve	Organizimi i kampanjave dhe fushatave vetëdijësuese; Ligjërata; Plotësimi i modulit të trajnimit bazik për zyrtarë policor

2. Trajtimi post-traumatik i hetueëve dhe krimteknikëve në vendin e ngjarjes	TM1 2024 TM4 2026				PK	DSHSH	Departamentet Policore	Ligjëratë për menaxhimin e stresit post-traumatik; Seanca këshilluese; Hartimi I një manuali për parandalimin e PTS; Organizimi i nëntë ligjëratave vetëdijësuese për parandalimin e stresit PTS.
3. Programi i screening për zbulim të hershëm të kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës së mitrës	TM1 2024 TM4 2026				PK	DSHSH	Departamentet Policore	Numri i zyrtareve të akzaminuara
4. Ofrimi i përkrahjes psikologjike për zyrtarët më të cenueshëm në PK	TM1 2024 TM4 2026				PK	DSHSH	Departamentet Policore	Numri i zyrtareve të përkrahura
5. Realizimi i incizimit DEXA (osteoperoza)	TM1 2024 TM4 2026				PK	DSHM	Departamentet Policore	Parandalimi i hershëm i osteoperozës
Objektivi Specifik 5.2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit					Baza	Caku 2025	Caku 2026
Promovimi dhe kujdesi për mirëqenien e punonjësve të PK-së	Mirëqenia e përmirësuar dhe kujdesi i rritur për punonjësit e PK-së					50%	60%	65%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Njësia përgjegjëse	Njësia mbështetëse	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
1. Senzibilizimi lidhur me rëndësinë që ka aktiviteti fizik për shëndetin dhe mirëqenien	TM1 2024 TM4 2026				PK	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore	Udhëzime, broshura dhe ligjëratë
2. Organizimi i aktiviteteve të karakterit social dhe mendor	TM1 2024 TM4 2026	5,000 €	5,000 €	5,000 €	PK dhe partnerët	Divizioni i Trajnimeve	Departamentet Policore	Realizimi i shëtitjeve, ecjeve në natyrë

